EDUCO

Education for Development and Cultural Outreach

Education for Development and Cultural Outreach

Edukimi për Zhvillim dhe Shtrirje Kulturore

EDUCO

RAPORTI VJETOR 2023

Rr. Zahir Pajaziti nr.100, 20000, Prizren, Kosovë
ojq.educo@gmail.com / www.ojqeduco.org

2 Punëtori

2 Trajnime

80+ Pjesëmarrës në Konferencë

10 Epizode EDUCO Podcast

2 EDUCO Videos

2 Bashkëpunime

19 Aktivitete

PËRMBLEDHJE

Organizata Jo-Qeveritare Edukimi për Zhvillim dhe Shtrirje Kulturore EDUCO zyrtarisht është regjistruar me datën 11/01/2023.

Për të arritur qëllimet si organizatë, përgjatë vitit 2023 EDUCO ishte pjesëmarrës në 19 aktiviteteve të ndryshëm.

Organizoi 2 punëtori: njëra me mbështetje nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit - Komuna e Prizrenit dhe punëtorinë tjetër në bazë vullnetare.

Organizoi 2 trajnime, ku u certifikuan 15 pjesëmarrës.

Organizoi edicionin e parë të Konferencës për Turizëm dhe Mikpritje në Prizren, me mbështetje nga Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik - Komuna e Prizrenit, ku morrën pjesë më shumë se 80 pjesëmarrës.

Publikoi 10 epizode të Podcast sipas programit.

Realizoi 2 video të shkurtëra.

Përfundoi 2 projekte me bashkëpunim.

1 ZHVILLIMI I METODAVE INOVATIVE TË MËSIMIT PËR RESTAURIMIN E ARTEFAKTEVE ARKEOLOGJIKE

Fillimisht është filluar me pregaditjen administrative të projektit, ku janë përzgjedhur stafi i cili është angazhuar në projekt si dhe trajnuesi i cili ka qenë i angazhuar gjatë punëtorive të restaurimit.

Më pas sipas nevojave të trajnerit është filluar me pregaditjen teknike e cila ka qenë pregaditja e hapësirës së punëtorisë, pregaditja e invertarit të punëtorisë, blerja e materialeve për restaurimin e artefakteve (-Brusha të ndryshme, Doreza, Mjete pune të dorës (sharra, pinceta, prerëse të ndryshme, mistria të vogla, gërshërë, etj,), Peshore, metër, letër ngjitëse, letër pause, lapsa, ngjyra, etj., Material pune (ngjitës letre, ngjitës trasparent i lëngët, ngjitës i ngurët, aceton, gips, lëng pastrues, antikorrodant, sfungjerë, tel metali, penjë, etj.), më pas është bërë blerja e materialit shpenzues për pregaditjen e projektit (Letra, dosja, lapsa, ngjyra, etj.).

Me datë 13 korrik është hapur thirrja për pjesëmarrës në Punëtorinë e Restaurimit të Artefakteve të Muzeut Arkeologjik të Rajonit të Prizrenit ku kanë aplikur mbi 20 pjesëmarrës.
Me datë 21 shtator janë përzgjedhur 10 pjesëmarrës të cilët janë ftuar të jeni pjesë e punëtorisë 5 ditore.

Me datë 26 shtator filloi dita e parë e punëtorisë në Muzeun Arkeologjik të Rajonit të Prizrenit e cila ku për qëllim kishte prezentimin e ekspozitës së muzeut dhe punët e më hershme të restaurimit.

Me datë 27 shtator filloi dita e dytë e punëtorisë e cila ishte pjesa e ligjeratës për informacione të përgjithshme rreth trashëgimisë kulturore dhe informata të përgjithshme historike. Më pas pjesëmarrësve i'u dha detyra që të gjejnë pjesët e thyera të enëve të dheut të cilat duhet të identifikoheshin dhe të përmblidhen në pjesët e tyre të caktuara.

Me datë 28 shtator në ditën e tretë pjesëmarrësit janë aftësuar se si bëhet ngjitja adekuate e pjesëve të enëve dhe se si të mbushen dhe rikonstruktohen hapësirat e zbrazëta dhe pjesët që mungojnë në të. Teknika të mbushjes, gryerjes, rrafshimit dhe lëmimit ishin disa prej metodave që ata mësuan në ditën e tretë të punëtorisë.

Me datë 29 shtator në ditën e katërt në punëtorinë e restaurimit, pjesëmarrësit janë mësuar rreth pastrimit të enëve pas restaurimit dhe konzervimit. Po ashtu, kanë pasur rastin që të jenë pjesë e restaurimit të Pitosit mijëvjeçar i cili ishte në gjendje të copëtuar. Aty kanë pasur fatin të shohin se si bëhet një restarim i artefakteve të cilat janë shumë të vlefshme dhe pasuri e trashëgimisë kulturore të vendit tonë

Me datë 30 shtator, pra në ditën e fundit të punëtorisë, pjesëmarrësit kanë ekspozuar punimet e tyre të enëve të restauruara. Atë ditë janë shpërndarë edhe certifikatat të cilat vërtetojnë se ata janë aftësuar me informata të mjaftueshme për fushën e restaurimit të artefakteve arkeologjike

Projekti "Prizreni në Epokën e Re: Zhvillimin e Metodave Inovative të Mësimit për Restaurimin e Artefakteve Arkeologjike" ka prodhouar rezultate të rëndësishme në fushën e konservimit dhe ruajtjes së trashëgimisë kulturore dhe historike. Në vijim janë disa nga rezultatet pas përfundimit të projektit:

-Rritja e vetëdijes dhe informacionit të publikut rreth rëndësisë së ruajtjes dhe konservimit të trashëgimisë kulturore dhe historike të Prizrenit dhe rajonit.

-Zhvillimi i metodave të inovative të mësimit dhe trajnimit të specialistëve në fushën e konservimit dhe ruajtjes së artefakteve arkeologjike.

-Rritja e kapaciteteve lokale dhe rajonale në fushën e konservimit dhe restaurimit të trashëgimisë kulturore dhe historike, duke u mundësuar një mbështetje më e mirë për këto aktivitete në të ardhmen.

2 COMMUNITY CARTOGRAPHERS: MAPPING ITP MAPATHON AND MEETING OVER DRINKS

EDUCO ne bashkëpunim me FLOSSK Free Libre Open Source Software Kosova dhe Space SyntaKs organizuan punëtorinë OSM Geohraphy Awareness Week 2023.

1 Trajnim dhe Certifikim i Udhërrëfyesve Turistik të Rinjë

Në modulin e parë; Hyrje ne Zhvillimin e Turizmit nga trajnimi "Trajnim dhe Certifikim i Udhërrëfyesve Turistik të Rinjë" pjesëmarrësit janë informuar mbi zhvillim e turizmit dhe metodat inovative të saj. Në ditën e dytë të trajnimit është vazhduar me modulin e rradhës "Hyrje në zhvillimin e udhërrëfyesve turistik" ku pjesëmarrësit janë njoftuar mbi llojet e udhërrëfyesve turistik dhe teknikat më të mira për të pasur sukses në punën e udhërrëfimit.

Në ditën e tretë të trajnimit të udhërrëfyesëve turistik në OJQ EDUCO, ka pasur një diskutim të frytshëm dhe pasionant rreth atraksioneve më të rëndësishme dhe të veçanta që ofron Kosova për turistët.

Për pjesëmarrësit, kjo është një mundësi e madhe për të zhvilluar njohuritë e tyre dhe për të bërë një ndikim pozitiv në industrinë e turizmit dhe promovimin në Kosovë.

Përfundimi i suksesshëm i trajnimit dhe certifikimit të udhërrëfyesëve turistik në OJQ EDUCO është një arritje për të gjithë pjesëmarrësit. Me sukses kaluan testin me shkrim si dhe atë praktik. Në pjesën praktike janë prezantuar disa monumente të trashëgimisë kulturore në Prizren duke marrë detyrën e udhërrëfyesit, tani e tutje pjesëmarrësit kanë njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të udhëhequr me sukses udhërrëfimin.

Trajnimi është organizuar në bazë vullnetare nga OJQ EDUCO

2 Trajnim QGIS

EDUCO ka organizuar trajnim për QGIS, një fushë shumë e rëndësishme në tregun e Kosovës por jo vetëm. Trajnimi është mbajtur prej Besfort Guri nga OpS-IN dhe zgjati 4 javë, ku janë certifikuar 9 pjesëmarrës.

Dita e partë e trajnimit kishte për qëllim aftësimin në bazat e para të kësaj fushe. Ndërsa dita e dytë filloi me prezentimin e ndërfaqes të programit dhe me modulin e punimit në Vektor, Raster, etj.

Në javën e dytë të trajnimit në QGIS, pjesëmarrësit kanë kaluar në fazën e zhvillimit, procesimit dhe analizimit e të dhënave përmes mjeteve të ndryshme të cilat i mundëson programi i QGIS.

Si përfundim pjesëmarrësit poashtu kanë mësuar rreth Simbologjisë dhe Emërtimit të Gjeometrive si dhe për Print Layout dhe Atlas

Si dhe me sukses është pëtfunduar trajnimi në QGIS, i cili zgjati 4 javë me 8 module të ndryshme me 9 pjesëmarrës.

Trajnimi është organizuar në bazë vullnetare nga OJQ EDUCO

Konferenca e Turizmit dhe e Mikpritjes

në Prizren

Fillimisht është filluar me pregaditjen administrative të projektit, ku janë përzgjedhur stafi i cili është angazhuar në projekt. Më pas është filluar me mbledhjen e kontakteve të institucioneve dhe materialeve të tjera të nevojshme për përgatitjen e doracakut dhe pas të gjitha informacioneve që janë grumbulluar është bërë Dizajni i doracakut, shtypja e prototipeve dhe shtypja finale e doracakut (fotografia e bashkangjitur).

Më pas ka filluar edhe pregaditja e Konferencës së Turizmit dhe e Mikpritjes në Prizren, ku pas shumë diskutimeve është vendosur që emrin ta ketë “KonTur”. Kjo konferencë planifikohet që të organizohet çdo vjet me edicione të ndryshme duke shpresuar që do të arrijë madhësinë e konferencave ndërkombëtare.

Kanë filluar pregaditja e Panelistëve dhe Mysafirëve folës. Është planifikuar që të jenë tre panele dhe 6 mysafir folës gjatë konferencës.

Në panel ishin:

-Kryetari i Komunës së Prizrenit – Shaqir Totaj

-Drejtoresha e DTZHE – Lirija Bytyqi

-Drejtori i QRTK – Samir Hoxha

-MINT – Irfan Lipovica

-DokuFest – Alba Çakalli

-Autostrada Biennale – Vatra Abrashi

-Flosk (FOSS4G) – Besfort Guri

-Qendra e Kompetencës – Edona Turtulla

-Shoqata e gastronomëve – Ilir Shala

Nga mysafirët folës ishin:

-Muezu Arkeologjik i Rajonit të Prizrenit – Vesel Hoxhaj

-Prof. Zekë Çeku

-Turizmi Rural – Arbnore Kolgjeraj

-Eco Tur – Bekim Bytyqi

-Filigrani – Durim Haxhifazliu

-Sy rrushi – Brikena Gashi

Konferenca u mbajtë me datë 18 nëntor 2023, në hapësirat e Kino Lumbardhit nga ora 11:00.

Agjenda e KonTur 2023

EDUCO

18.11.2023
11:00h
Kino Lumbardhi

Hapja				
1	Hapja e konferencës	**Fisnik Minci**	Moderator	11:00-11:10
2	Prezantimi i OJQ EDUCO	**Veron Tara**	Drejtor ekzekutiv dhe bashkëthemelues	11:10-11:20
Paneli 1				
1	Turizmi në Prizren	**Shaqir Totaj**	Kryetari i Komunës së Prizrenit	11:20-11:30
2	Turizmi dhe rëndësia e tij	**Rozeta Hajdari**	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë	11:30-11:40
3	Turizmi në Prizren	**Lirija Xhemaj-Bytyçi**	Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik-Prizren	11:40-11:50
4	Roli i QRTK-së në turizmin e qytetit	**Samir Hoxha**	Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore-Prizren	11:50-12:00
5	Pyetje dhe Përgjigje			12:00-12:10
Mysafirët folës				
3	Turizëm dhe Mikpritje	**Zekë Çeku**	Mysafir	12:10-12:15
4	Muzeu Arkeologjik i Rajonit të Prizrenit	**Vesel Hoxhaj**	Mysafir	12:15-12:20

Pauzë 10 min.

Paneli 2				
1	Roli i Dokulest në zhvillimin e turizmit prizrenas	**Alba Çakalli**	Dokufest	12:30-12:40
2	Impakti i Autostrada Biennale në turizmin vendas	**Vatra Abrashi**	Autostrada Biennale	12:40-12:50
3	Rëndësia e konferencave ndërkombëtare në Prizren	**Besfort Guri**	FOSSAG 2023 / FLOSSK	12:50-13:00
4	Pyetje dhe Përgjigje			13:00-:13:10
Mysafirët folës				
1	Turizmi Rural	**Arbnora Kolgjeraj Rexha**	Mysafire	13:10-13:15
2	Shëtni Eco Tour	**Bekim Bytyqi**	Mysafir	13:15-13:20

Pauzë 10 min.

Paneli 3				
1	E ardhmja e turizmit me Qendrën e Kompetencës	**Edona Turtulla Rada**	Qendra e Kompetencës - Prizren	13:30-13:40
2	Puna e shoqatës për turizmin	**Ilir Shala**	Oda e Gastronomëve - Prizren	13:40-13:50
3	Pyetje dhe Përgjigje			14:00-14:10
Mysafirët folës				
1	Filigrani	**Durim Haxhifazliu**	Mysafir	14:10-14:15
2	SYRRUSH	**Brikena Gashi**	Mysafire	14:15-14:20

Rrjetëzimi	
Sweets & Talks	Prej 14:20

www.kontur.ciqeduco.org

Në konferencë kanë marrë pjesë rreth 80 pjesëmarrës fizikisht dhe rreth 50 shikues në linjë direkte.

Për ndihmë në organizimin e konferencës kemi pasur 6 vullnetarë të cilët kanë ndihmuar rreth pregaditjeve teknike, logjistike dhe ndihmuese.

Promovimi

Gjatë muajit Tetor dhe Nëntor janë bërë pregaditjet administrative dhe logjistike për konferencën, por gjithashtu edhe promovimi medial i saj.

Të gjitha publikimet janë bërë në:

www.ojqeduco.org

www.kontur.ojqeduco.org

www.facebook.com/ojq.educo

www.instagram.com/ojq.educo

www.youtube.com/@ojqeduco

dhe poashtu në disa Televizione lokale të Prizrenit.

Konferenca poashtu ka qenë duke u transmetuar në linjë direkte në ueb faqën tonë, në Facebook dhe në Katror Media.

Objektivat

MICKEY

TRADITË
KONTUR

Rezultatet

Janë identifikuar indikatorët e performancës për të vlerësuar përparimin dhe arritjet e projektit. Këta indikatorë kanë qenë të lidhur me objektivat dhe synimet e thirrjes publike dhe kanë përfshirë aspekte të tilla si numri i pjesëmarrësve, nivelin e angazhimit, ndryshimet e perceptimeve dhe sjelljeve të qytetarëve dhe ndikimin në politikat publike. Gjithashtu, do të monitorojmë vazhdimisht përparimin dhe arritjet e projektit duke përdorur indikatorët e performancës të identifikuar. Kjo do të përfshijë mbledhjen e të dhënave dhe vlerësimin e tyre për të identifikuar trendet dhe përparimin në raport me synimet e projektit. Në mes të procesit, do të bëjmë një vlerësim mesatar të projektit për të identifikuar suksesin dhe sfidat e projektit. Kjo do të ndihmojë të ndryshojmë planin tonë nëse është e nevojshme dhe të identifikojmë rëndësinë e ndryshimeve që duhet të bëjmë. Dhe një vlerësim të fundit të projektit për të vlerësuar arritjet dhe ndikimin e projektit në përmbushjen e objektivave të thirrjes publike do të përfshijë një analizë të thellë të të gjitha të dhënave dhe dokumentacionit të mbledhur gjatë projektit. Në fund, do të raportojmë dhe komunikojmë rregullisht përparimin dhe arritjet e projektit me donatorët dhe publikun e gjerë.

Qëndrueshmëria

Ndërtimi i një biznes plani të qartë dhe të detajuar: Një biznes plan i mirë i strukturuar do të ndihmojë në identifikimin e burimeve të mundshme të të ardhurave dhe në planifikimin e kostove për konferencën e ardhshme të turizmit. Ky plan do të përmbajë strategjitë për marketing, planifikimin financiar, zhvillimin e vazhdueshëm të produkteve dhe shërbimeve, si dhe rritjen e vendosmërisë së të ardhurave.

Përqendrimi në ngritjen e kapaciteteve: Pas përfundimit të mbështetjes financiare publike, ne do të kemi kapacitete të mjaftueshme për të menaxhuar konferencat e ardhshme të turizmit me sukses. Kjo do të përfshijë trajnime për menaxhimin e konferencave, zhvillimin e shërbimeve në vend, rritjen e marrëdhënieve me sponsorët dhe pjesëmarrësit, si dhe përdorimin e teknologjisë së re për të ngritur kampanja të marketingut.

EDUCO PODCAST

EDUCO Podcast është një projekt inovativ që synon promovimin e artit dhe kulturës, trashëgimisë kulturore, diversitetit, sipërmarrjes dhe rinisë. Poashtu synon të nxjerr në pah zërat e të rinjve të talentuar dhe të luftojë kundër keqinformimit në fushat e tyre përkatëse.

EDUCO Podcast Sezona e parë:

Gjithsej 10 video:

1. Hana Arapi - Rrugëtimin në karrierën e saj si dizajnere si dhe shenjëzimi i Ditës Ndërkombëtare të Vajzave dhe Grave në Shkencë

2. Ema Jashari Skeja - Rrugëtimin në karrierën e saj si Psikologe si dhe shenjëzimi i Ditës Ndërkombëtare të Vajzave dhe Grave në Shkencë

3. Sejnur Veshall - Rrugëtimin e zyrtarizimit të Gjuhës Rome në Prizren si dhe shenjëzimin e Ditës Ndërkombëtare të Gjuhës Amtare

4. Artan Xhaha - Projektet te realizuara në Kosovë dhe në tregun ndërkombëtar, sfidat dhe rekomandimet për dizajnerët e ardhshëm.

5. Vesel Hoxhaj - Drejtimi i arkeologjisë dhe Muzeu Arkeologjik i Prizrenit

6. Nita Reshtani Pecani - Punimet e ornamenteve dhe frymëzimi për të bërë dicka autentike

7. Arbnor Morina - Fillimet e tij si piktor dhe eksperiencën në punën e tij

8. Durim Haxhifazliu dhe Fahridin Haxhifazliu - Mjeshtër të filigrani të cilët e vazhdojnë traditën shumëvjeçare të qytetit, atë të artizanatit të filigranit.

9. Arlinda Shatri - Antropologe një vajzë me pasion të madh për antropologjinë

10. Ekipi i EDUCO Podcast - Promovimi i Konferences se Turizmit dhe Mikpritjes

Ky program i EDUCO Podcast realizohet në bazë vullnetare

EDUCO VIDEOS

EDUCO Videos është pjesë e programit të Media-së dhe përqëndrohet në realizimin e videove, për të shënuar aktivitetet që ndodhin në ditë të caktuara të kalendarit. Temat e përzgjedhura përfshijnë promovimet e ndryshme dhe shënime të ditëve të veçanta, duke krijuar video edukative përmes diskutimeve dhe prezantimeve. Përmes këtyre videove synimi është shpërndarja e mesazheve të rëndësishme edukative dhe frymëzimi i audiencës.

- **Grupi Jo-Formal i OJQ-ve | Koncert Artistik për 17 shkurt**

Video përmbledhëse e përgatitur nga Grupi-Jo Formal i OJQ've të Prizrenit

- **Dita Botërore e Bletave**

Storie e përgatitur për Ditën Botërore të Bletëve, së bashku me Edin Geshtenja.



Ky program i EDUCO Podcast realizohet në bazë vullnetare

BASHKËPUNIMET

Në 18 maj, në Muzeun Arkeologjik në Prizren u shënua Dita Ndërkombëtare e Muzeve. Në këtë ditë, u nënshkrua një marrëveshje bashkëpunimi në mes të Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore – Prizren dhe OJQ EDUCO në Prizren. Kjo marrëveshje synon të promovojë edukimin, aftësimin dhe pjesëmarrjen aktive të të rinjve në ruajtjen e Trashëgimisë Kulturore, duke zhvilluar aftësitë e restaurimit dhe marrjen e masave për të mbrojtur artefaktet arkeologjike.

Nëpërmjet kësaj marrëveshje, QRTK – Prizren dhe organizata joqeveritare EDUCO synojnë të përfshijnë shoqërinë civile në përkrahjen e trashëgimisë kulturore në Prizren, duke i dhënë një kontribut pozitiv ruajtjes dhe mbrojtjes së saj.

Dita Ndërkombëtare e Muzeve promovon rolin e tyre në komunitet dhe sensibilizon qytetarët mbi rëndësinë e vizitës dhe përkrahjes së muzeve si institucione të rëndësishme për ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore dhe historike.

SHTËPI SHKOLLA

Me datë 25 tetor 2023 është nënshkruar Memorandum Mirëkuptimi në mes të Komuna e Prizrenit, përkatësisht me Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren si dhe Institutit Space SyntaKs me qëllim të bashkëpunimit të përbashkët.

Projekti ka për qëllim vazhdimin e plotësimit dhe zhvillimit të Platformës Digjitale Nënshkruam Memorandum Bashkëpunimi me Institutin Space SyntaKs për bashkëpunim dhe angazhim për të plotësuar platformën digjitale "Shtëpi Shkolla", e cila do ti dedikohet ruajtjes së kujtesës kolektive për mësimin paralel gjatë viteve të 90'ta në Kosovë.

SHTËPI SHKOLLA

Me datë 25 tetor 2023 është nënshkruar Memorandum Bashkëpunimi me Institutin Space SyntaKs për bashkëpunim dhe angazhim për të plotësuar platformën digjitale "Shtëpi Shkolla" për rajonin e Prizrenit.

Ky bashkëpunim është një hap i rëndësishëm drejtë njohjes së historisë së arsimit dhe kulturës mësimdashëse të vendit tonë.

1

Konferenca Internacionale “CYBER ZERO”

Është mbajtur në Prishtinë me datë 26-27 Janar 2023.

Me transformimin digjital anë e mbanë, këto tematika kanë rëndësi për tu njohur dhe trajtuar.
Pikërisht në këtë konferencë internacionale po trajtohen tematikat për edukim të sigurisë kibernetike.

Ne si OJQ EDUCO në aktivitetet tona kemi qëllimin e edukimit të rinjëve në Prizren për tematikat aktuale.



2

Shënimi i 5 vjetorit të “MakerSpace Prizren”

Është shënuar 5 vjetori i themelimit të MakerSpace Innovation Center në Prizren me datë 26-27 Janar 2023.

3

Nënshkrimi i Zotimit të Agjendës së Kontratës Sociale për Prizrenin

Me datë 09.02.2023 së bashku me Komunën e Prizrenit dhe qytetarët, është nënshkruar Zotimi i Agjendës së Kontratës Sociale për Prizrenin.

• Të mbështetë bashkëpunimin e hapur, të sinqertë dhe domethënës midis zyrtarëve komunal dhe qytetarëve për të zgjidhur çështjet e qytetarëve
• Të ndihmojë qytetarët dhe zyrtarët komunal që të kuptojnë më mirë përgjegjësitë dhe kontributet e njëri-tjetrit
• Të inkurajojë respektin për diversitetin e përvojave dhe opinioneve të qytetarëve dhe zyrtarëve publik
• Të ndërtojë besimin në mes qytetarëve dhe administratave komunale.

4

Proklamimi i të drejtave gjuhësore tek komunitetet pakicë

NGO “Durmish Aslano” me datë 10 Shkurt 2023 ka mbajtur konferencën me temë “Proklamimi i të drejtave gjuhësore tek kominitetet pakicë”, e cila ngërthen promovimin e procesit historik të Gjuhës Rome në Komunën e Prizrenit mbi promovimin si gjuhë zyrtare në përdorim tradicional dhe diskutimin me akterët relevant të cilët kanë kontribuar në mbrojtjen dhe përdorimin e gjuhës rome në Kosovë.

Njëra ndër qëllimet dhe fushat e veprimtarisë së EDUCO për trashëgiminë kulturore është mbështetja, ruajta, promovimi dhe zhvillimi i trashegimisë kulturore i të gjitha komuniteteve në vendin tonë!

5

Grupi Jo-Formal i Organizatave Rinore të Prizrenit mbajti mbledhjen e radhës ku u diskutuan aktivitetet për nder të 17 Shkurtit. Prizren, Kosovë.

6

Koncert Artistik për Ditën e Pavaresisë – 17 Shkurt 2023, Prizren, Kosovë

Është mbajtur Koncerti Artistik për Ditën e Pavaresisë së Kosovës. EDUCO së bashku me shumë OJQ e organizuan këtë koncert.

7

Konsorciumit për të drejta të punës me ATRC - 9 Mars 2023 - Prishtinë, Kosovë

Takim online me rrjetin e ATRC-së në lidhje me konsorciumin e të drejtave të punës.

8

Avokimi që pushimi atësor dhe i lehonisë të jenë të përfshiera në kuadër të Ligjit të Punës 15 Mars 2023 - Prishtinë, Kosovë

Takim online me rrjetin e ATRC-së në lidhje me avokimin që pushimi atësor dhe i lehonisë të jenë të përfshiera në kuadër të Ligjit të Punës.

9

Nënshkrues të letrës avokuese dërguar deputetëve të Republikës së Kosovës, për miratimin e ligjit për pagën minimale 24 Prill 2023 - Prishtinë, Kosovë

10

Nënshkrim i kontratës për projektin "Konferenca e Turizmit dhe Mikpritjes në Prizren" nga subvencionet e Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik nga Komuna e Prizrenit - 10 Maj 2023 - Prizren, Kosovë



11

Diskutim për funksionalizimin e Këshillit Nacional për Siguri dhe Shëndet në Punë

Takim online me rrjetin e ATRC-së për të diskutuar për funksionalizimin e Këshillit Nacional për Siguri dhe Shëndet në Punë me datë 24 Maj 2023.

12

Hulumtim për të drejtat e punës për komunitetet, Rom, Ashkali dhe Egjiptas

"Konferenca mbi gjuhën, përdorimin dhe mbrojtjen e gjuhës rome", e cila ngërthen promovimin e procesit historikë të gjuhës rome në Komunën e Prizrenit mbi promovimin si gjuhë zyrtare në përdorim tradicional dhe diskutimin me akterët relevant të cilët kanë kontribuar në mbrojtjen dhe përdorimin e gjuhës rome në Kosovë. 30 Maj 2023. Prizren, Kosovë

13

EDUCO në bashkëpunim me Gjimnazin "Gjon Buzuku Prizren" dhe Shkolla "Izmir Fevzi Özakat" në Turqi, realizuan vizitë në muzeun e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe Muzeu Arkeologjik i Rajonit të Prizrenit. Nxënësit janë njoftuar me historinë e vendit tonë, vlerat dhe artefaktet të cilat i përmbajnë këto muze. 6 Qershor 2023. Prizren, Kosovë

14

Dita e Gruas në Biznes

Konferencën "Dita e Grave në Biznes" është mbajtur me datën 22 Shtator 2023.

Ky aktivitet i dedikohet grave dhe vajzave për përfshirjen e tyre në biznes, Ditë kjo që shënohet edhe në shumë shtete të botës.

15 Nënshkrim i i një marrëveshje bashkëpunimi në mes të Drejtorisë Komunale të Arsimit - Prizren dhe OJQ EDUCO – 25 tetor, 2023, Prizren, Kosovë

16 Vizitë në Ekspozitën e veshjeve tradicionale Zym të Hasit, Kosovë 4 Nëntor, 2023

"ARKA E ZYMIT: Koleksioni i veshjeve hasjane "ngjarje e cila synoi të pasqyrojë pasurinë dhe trashëgiminë kulturore të Hasit. Kjo ekspozitë ishte një rrëfim, një udhëtim e një indentitet sepse çdo copë pëlhurë e pjesë e veshjeve është një fjalë e heshtur e qëndisur në çdo motiv dhe e shprehur në çdo ngjyrë.

17

Shoqëria dhe politika në formësimin e diskursit publik dhe gjinor. Prizren, Kosovë 10 Nëntor, 2023

Tema e diskutimit tonë ishte mbi shoqërinë dhe politikën dhe rolin e tyre në formësimin e diskursit publik dhe gjinor.

18

Mentorimi i Ndryshimeve Klimatike per studentet e Universitetit Ukshin Hoti



19

“55 Vjetori i themelit te OJQ Durmish Asllano”

Emocionet e Melodive: 55-vjetori i OJQ Durmish Aslano dhe Udhëtimi i Trashëgimisë Shpirtërore Rome. Koncert Artistik të organizuar në Prizren, Kosovë me datën 22 Dhjetor 2023.

FALENDEROJMË PËR KONTRIBUTIN:

Sejnur Veshall

Gynesh Veshall

Mijedin Shope

Benjamin Menekshe

Gjynejt Kallo

Katarina Kajtazi

Gjeni Krasniqi

Flamur Kadiri

Venhard Gota

Ardian Muçaj

Nora Simitçiu

Tringa Kasemi

Artnet Haskuka

Besfort Guri

Izet Izeti

Bekir Jonuzi

Mustaf Shigjeqi

Istref Krasniqi

Makerspace Innovation Center

Fondacioni “Lumbardhi”

Opentel

TV PRIZRENI

Katror Media

MUND TË NA NDJEKNI NË:

ojqeduco.org

kontur.ojqeduco.org

Instagram.com/ojq.educo

Facebook.com/ojq.educo

Youtube.com/@ojq.educo

linkedin.com/company/ojqeduco

tiktok.com/@ojq.educo

open.spotify.com/ojq.educo

EDUCO

Education for Development and Cultural Outreach